



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



PROMOTING  
PRIVATE SECTOR  
EMPLOYMENT

# NDIKIMI EKONOMIK I PANDEMISË COVID-19 NË SEKTORIN E HOTELERISË DHE AKOMODIMIT NË KOSOVË

27 mars 2020

Prishtinë

Mohimi i përgjegjesisë:

Hartimi dhe botimi i këtij dokumenti është mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes projektit të vet - Promovimi i Punësimit të Sektorit Privat (PPSE), i zbatuar nga Swisscontact në konsorcium me Institutin Riinvest.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e PPSE-së dhe nuk paraqet domosdoshmërisht pikëpamjet e SDC-së.

  
swisscontact




## NDIKIMI EKONOMIK I PANDEMISË COVID-19 NË SEKTORIN E HOTELARISË DHE AKOMODIMIT NË KOSOVË

Ky raport ofron një përmbledhje të shkurtër të kostove të mundshme ekonomike në sektorin e hotelarisë dhe akomodimit në Kosovë. Industria e udhëtimit dhe turizmit, e cila është pjesë e sektorit të hotelarisë dhe akomodimit, është një nga sektorët më të goditur nga kriza aktuale e pandemisë. Poashtu, kjo konfirmohet edhe nga UNWTO, sipas të cilit, industria globale vlerësohet se do të pësojë humbje deri në 50 miliardë dollarë amerikan<sup>1</sup> (USD). Për më tepër, vlerësimet e sakta janë të pamundura për t'u paraqitur tani, për shkak të trajektores së pasigurt të krizës së pandemisë. Duke pasur parasysh këto paqartësi, qëllimi i këtij raporti nuk është të vlerësojë kostot e krizës së pandemisë në sektorin e hotelarisë dhe akomodimit në Kosovë, por të sigurojë një vlerësim të gjerë për ndikimin e mundshëm.

Analizat në këtë raport bazohen në statistikat zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), konkretisht nga 'Rezultatet e Anketës Strukturore të Biznesit 2018', si dhe pjesërisht të bazuara në 'Anketën e Ofertës së Turizmit' të projektit – Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE). Ndikimi ekonomik është i kufizuar në sektorin e hotelarisë dhe akomodimit, i cili sipas ASK-së përfshin 'akomodimin dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit'<sup>2</sup> - bazuar në klasifikimin e NACE. Ky sektor përfshin njësitë ofruese të akomodimit, ushqimit dhe pijeve, të cilat mund të referohen në kuadër të sektorit HoReCa (ang. hotels, restaurants, catering shq. hotele, restorante, furnizim me ushqim). Ky sektor është ndikuar shumë për shkak të krizës së pandemisë, kryesisht për shkak të masave që kufizojnë lëvizjen (mbyllja) si dhe ndaljes së turizmit.

### **Përmbledhje e madhësisë së sektorit**

Sipas ASK-së, numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve aktive në vitin 2018, në sektorin e hotelarisë dhe akomodimit është **3,683** sosh. Kjo përfaqëson mbi **10%** të numrit të përgjithshëm të NVM-ve aktive në Kosovë. Kontributi i këtij sektori në PBB-në e Kosovës vlerësohet rreth **1.3%**. Kjo përbën rreth **86.5 milion euro** qarkullim. Pothuajse **14,000** persona janë të



<sup>1</sup> <https://www.unwto.org/impact-assessment-of-the-covid-19-outbreak-on-international-tourism>

<sup>2</sup> ASK, Statistikat Ekonomike: Rezultatet e Anketës Strukturore të Biznesit 2018.

punësuar dhe të vetë-punësuar në këtë sektor, që përbën rreth 3.7% të numrit të përgjithshëm të personave të punësuar në Kosovë. Paga mesatare mujore në këtë sektor është **254 euro**.

### Metodologjia e vlerësimeve

Vlerësimet e mëposhtme bazohen në të dhënat zyrtare të ASK-së (të paraqitura më lart) dhe përmes llogaritjeve të Anketës së Ofertës së Turizmit të PPSE-së.<sup>3</sup> Konkretisht, shpërndarja e të ardhurave gjatë muajve si dhe ndarja e punonjësve sezonalë dhe me orar të plotë pune, bazohet në Anketën e Ofertës së Turizmit, ndërsa të dhënat për qarkullimin e sektorit dhe punonjësit rrjedhin nga të dhënat e ASK-së. Për të vlerësuar ndikimin ekonomik, supozohet se ndërmarrjet brenda këtij sektori do të përfundojnë veprimtarinë e tyre ekonomike për një periudhë prej dy muajsh. Ky supozim bazohet në kohëzgjatjet e mundshme të afateve kohore të kufizimit të lëvizjes "mbylljes". Sidoqoftë, vlerësime të tjera mund të bëhen në varësi të kohëzgjatjes së krizës. Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen e të ardhurave sezonale në sektorin e akomodimit, ofruesve të shërbimit të ushqimit dhe pijeve.<sup>4</sup>




Figura 1. Shpërndarja e të hyrave të NVM-ve në sektorin HoReCa

Grafiku i mësipërm paraqet se muajt e parë të vitit janë zakonisht "sezoni i ulët" i NVM-ve në këtë sektor. Nëse supozohet se aktiviteti i biznesit do të përfundojë gjatë muajve prill dhe maj, bazuar në të dhënat e mësipërme, sektori mund të humbasë rreth 15% të qarkullimit vjetor. Kjo përfaqëson një përpjesë të konsiderueshme, për më tepër, sektori i hotelarisë dhe akomodimit

<sup>3</sup> Anketa e Ofertës së turizmit PPSE 2018.

<sup>4</sup> Llogaritjet e autorit bazuar në të dhënat e paraqitura në Anketën e Ofertës së Turizmit të Kosovës 2018.

ndikon në sektorë të tjerë të ndërlidhur (d.m.th. zinxhirët e furnizimit), ku ndikimi ekonomik vlerësohet të jetë afër ndikimit të përgjithshëm të vetë sektorit të hotelarisë dhe akomodimit.<sup>5</sup>

Sa i përket llojit të të punësuarve, sektori karakterizohet me punonjës sezonalë pasi që i njëjti konsiderohet të ketë sezonalitet. Rreth **14%** e numrit të përgjithshëm të punonjësve në këtë sektor supozohet të jenë punëtorë sezonalë, të cilët janë të punësuar nga NVM-të gjatë kulmit të sezonit (peak season) - midis muajve qershor dhe shtator. Bazuar në këtë, mund të argumentohet se pjesa e punonjësve të prekur për shkak të krizës së pandemisë është rreth **86%** e totalit të punonjësve të sektorit.

### **Vlerësimi i ndikimit të pandemisë në aspektin ekonomik në këtë sektor**

Duhet të theksohet se vlerësimet e dhëna në këtë raport nuk mund të jenë të sakta, duke marrë parasysh që ndikimi dhe kohëzgjatja e krizës është e panjohur për momentin. Qëllimi i këtij raporti është të paraqesë një vlerësim të gjerë mbi ndikimin e mundshëm, i cili mund të përdoret nga hartuesit e politikave dhe organizatave të tjera për të planifikuar masat mbështetëse. Për më tepër, të gjeturat janë paraqitur bazuar në burime dhe supozime të shumta.

Ndërprerja dy-mujore e aktivitetit të sektorit të hotelarisë dhe akomodimit mund të ketë ndikimin e mëposhtëm ekonomik në Kosovë:

- Më shumë se **12,000**<sup>6</sup> të punësuar do të jenë janë joaktivë, rrezikojnë të humbasin punën e tyre dhe nuk kanë të ardhura.
- Personat e punësuar në këtë sektor do të humbin një shumë totale mbi **6 milion EURO**<sup>7</sup> në paga.
- **3,683 NVM** do të ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejt me kosto prej rreth **13 milion EURO**<sup>8</sup> humbje të qarkullimit.
- Për shkak të mos-aktivitetit të sektorit të hotelarisë dhe akomodimit, ndikimi i mëtuqeshëm në sektorë ndërlidhës mund të jetë më shumë se **10 milion EURO**.

Nga ana tjetër, Organizata Botërore e Udhëtimit dhe Turizmit (ang. World Travel and Tourism Organization - WTTC) ka propozuar tre masa jetike për të gjitha qeveritë, për të mbështetur bizneset në sektorin e udhëtimit dhe turizmit:

---

<sup>5</sup> Vlerësimet për ndikimin indirekt dhe induktiv të sektorit të turizmit që PPSE përdorë për analizat e veta të brendshme janë bazuar në shumëzuesit e publikuar nga WTTC (Këshilli Botëror i Udhëtimit dhe Turizmit).

<sup>6</sup> Ky numër rrjedh nga numri i përgjithshëm i të punësuarve: 14,000 i shumëzuar me pjesën e punonjësve me orar të plotë pune (86%) - duke përjashtuar kështu punonjësit sezonalë.

<sup>7</sup> 12,000 punonjës të cilët fitojnë një pagë mesatare mujore prej 254 EURO për 2 muaj.

<sup>8</sup> Rreth 15% nga qarkullimi i përgjithshëm i sektorit prej 86.5 milion EURO gjenerohet gjatë muajve prill dhe maj.

- a. Ndihma financiare duhet të jepet për të mbrojtur të ardhurat e miliona punëtorëve në sektorët të cilët përballen me vështirësi të mëdha ekonomike.
- b. Qeveritë duhet të japin kredi me kamatë zero për kompanitë globale të udhëtimit dhe turizmit, si dhe miliona bizneseve të vogla dhe të mesme, si një stimulim për të parandaluar kolapsimin e tyre.
- c. Të gjitha taksat, detyrimet dhe kërkesat financiare për sektorin e udhëtimit duhet të hiqen me efekt të menjëhershëm të paktën për 12 muajt e ardhshëm.

Vendet në rajon kanë ndërmarrë disa masa ekonomike për të zbutur rënien ekonomike për shkak të pandemisë COVID-19.

### **Përvojat rajonale - Maqedonia e Veriut**

Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut do të mbështesë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme me një fond 5.7 milion EURO. Në varësi të numrit të të punësuarve, kompanitë do të jenë në gjendje të marrin kredi pa kamatë, me një periudhë mospagimi (grace period) prej gjashtë muajsh dhe një periudhë dy-vjeçare ri-pagimi, si ne vijim:

- mikro-ndërmarrjet (deri në 10 të punësuar) mund të marrin një kredi prej 3,000 deri në 5,000 EURO;
- ndërmarrjet e vogla (në mes 10 dhe 50 të punësuar) mund të marrin një kredi nga 10,000 deri në 15,000 EURO;
- kompanitë e mesme (në mes 50 dhe 250 të punësuar) mund të marrin një kredi nga 15,000 deri në 30,000 EURO.

Qeveria do të subvencionojë kontributet e pagave për muajt prill, maj dhe qershor 2020 në sektorët e turizmit, transportit dhe hotelarisë dhe akomodimit, si dhe për kompanitë e tjera të prekura. Subvencioni për një punonjës do të arrijë në 50% të pagës mesatare të paguar në vitin 2019, me disa kushte për kompanitë.

Kompanive të cilat kanë realizuar fitime si rezultat i aktivitetit biznesor në vitin 2020, do t'u kërkohet të kthejnë subvencionet për kontribute deri në 50% të fitimeve të tyre para tatimit. Për më tepër, duke iu nënshtruar të njëjtave kushte të cekura më lart, ndërmarrjet nga sektorët e turizmit, transportit dhe hotelarisë dhe akomodimit, si dhe kompanitë e tjera të prekura, do të lirohen nga pagesa e tatimeve në të hyra për korporata për muajt prill, maj dhe qershor. Do t'u sigurohet në mënyrë të pandërprerë hyrje dhe qarkullim tranzit të automjeteve me mallra.

Puna në fabrika dhe në vend punishte më të mëdha duhet të riorganizohen me ndërrime/turne, d.m.th. deri në katër ndërrime nëse është e nevojshme.

Krahas masave të lartcekura, Ministria e Financave e Maqedonisë së Veriut ka njoftuar masat dhe rekomandimet e mëposhtme:

- uljen e interesit ligjor të paracaktuar për 50% dhe ndryshimin e periudhës për të cilën Banka Kombëtare e Maqedonisë së Veriut përcakton normën e interesit të referencës;
- uljen e interesit ndëshkues për detyrimet ndaj sektorit publik nga 0.03% në 0.015%; dhe
- rekomandim për uljen e çmimeve për mirëmbajtjen e regjistrave fiskalë deri në 50% për ofruesit e shërbimeve të tilla.

### **Përvojat rajonale - Shqipëria**

Shqipëria do të mbështesë sektorin privat përmes Instrumentit të Garancisë Sovrane në shumën prej 11 miliardë lekë (100 milion USD). Kjo shumë do të vijë si një garanci për kompanitë që përballen me probleme me pagimin e pagave për punonjësit e tyre gjatë këtyre muajve, ku do ta kenë më të vështirë të gjejnë shërbime për ekzekutimin e lehtë të pagave. Kjo garanci ose hua afatshkurtër do të sigurojë që çdo familje të ketë të ardhura të mjaftueshme për të mbajtur veten gjatë kësaj periudhe të vështirë.

Banka Qendrore e Shqipërisë ka ulur normat bazë të kamatës nga një përqind në 0.5 përqind, por nuk do të falë pagesat e kamatës, të cilat do t'i shtohen vlerës së përgjithshme të çdo kredie. Qeveria ka premtuar se do të paguajë pagat e rreth 60,000 punonjësve të bizneseve të vogla ose të vetë-punësuarve, të cilat do të kushtojnë rreth 1.57 miliardë lekë (13 milion euro). Gjithashtu, do të dyfishojë përkohësisht përfitimet mujore të skemës sociale për rreth 70,000 familje shumë të varfëra me një kosto prej 340 milion lekë (rreth 2.8 milion euro).